



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 48

Tiranë – E hënë, 13 mars 2017

PËRMBAJTJA

		Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 2.3.2017	Për vlerësimin e punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2016.....	3103
Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 134, datë 10.3.2017	Për përcaktimin e nivelit të masave shtesë të sigurisë dhe llojin e masave që duhet të marrin subjektet në varësi të aktivitetit apo vlerësimit të rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit të tyre.....	3104
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Hekuran Abdyl Arixhiu.....	3109



REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE PËR VITIN 2016

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson:

- Veprimtarinë e pavarur të Zyrës së Komisionerit në monitorimin dhe mbikëqyrjen e së drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

- Punën ndërgjegjësuëse, parandaluëse, kontrolluëse, duke arritur rezultate më të mira, krahasuar me vitet e kaluara.

- Rolin aktiv të Zyrës së Komisionerit në marrëdhëniet ndërinstitucionale për të informuar mbi rëndësinë që merr transparenca dhe privatësia në kohët e sotme, por edhe për të identifikuar masat që kërkohet të merren për mbrojtjen e tyre.

- Realizimin e indikatorëve të strategjisë ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike dhe Strategjisë Antikorrupsion, duke arritur tregues konkret.

- Angazhimin dhe bashkërendimin e punës në ndjekjen e procedurës për certifikimin e Shqipërisë si vend me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

- Bashkëpunimin ndërkombëtar dhe shfrytëzimin e instrumenteve të ndryshme për rritjen e nivelit profesional të punonjësve.

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2016:

- Janë realizuar më shumë hetime administrative në fushën e së drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale në më shumë sektorë dhe me shtrirje gjeografike më të gjerë.

- Është rritur ndjeshëm numri i ankesave dhe trajtimi i tyre në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të ndryshuar.

- Janë monitoruar në mënyrë sistematike programet e transparencës dhe regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe është rritur veprimtaria ndërgjegjësuëse, me qëllim edukimin ligjor në të drejtën për informim.

- Indikatorit që Zyra e Komisionerit ka në suportin buxhetor të strategjisë ndërsektoriale të

reformës në administratën publike është realizuar plotësisht.

- Është dyfishuar numri i rekomandimeve dhe sanksioneve në mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe janë kryer më shumë verifikime mbi zbatueshmërinë e tyre.

- Është rritur numri i praktikave të trajtuara dhe vendimeve të dhëna lidhur me transferimin ndërkombëtar.

- Është rritur numri i njoftimeve dhe regjistrimeve nga kontrolluesit.

- Janë zhvilluar trajnime ndërkombëtare dhe në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

- Është rritur ekspertiza për projektakte ligjore, nënligjore dhe projekte të lidhura me respektimin e mbrojtjes së të dhënave personale.

Kuvendi i Shqipërisë, për vitin 2017, kërkon nga Zyra e Komisionerit:

- Thellimin e monitorimit dhe mbikëqyrjes së ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të ndryshuar.

- Rritjen e numrit të kontroleve dhe hetimeve administrative, lidhur me respektimin e së drejtës së informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, me fokus të veçantë inspektimet kryesisht me plan tematik dhe në sektorë të ndryshëm.

- Rritjen e masave administrative për shkelje ligjore të konstatuara, me fokus të veçantë mungesën e programeve të transparencës dhe regjistrat të kërkesave dhe përgjigjeve.

- Ndjekjen e zbatimit të strategjive ndërsektoriale në kuadër të së drejtës për informim, lidhur me indikatorët e matshëm.

- Dhënie të ekspertizës në vazhdimësi për përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e të dhënave personale, në përputhje me Rregulloren e re të Përgjithshme të BE-së për të Dhënat Personale.

- Verifikimin e vazhdueshëm të zbatimit të rekomandimeve dhënë kontrolluesve.

- Rritjen e fushatave ndërgjegjësuëse në të dyja fushat e veprimtarisë me institucione publike e private dhe shoqërinë civile.

- Vazhdimin e edukimit të nxënësve dhe mësuesve për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale në ambientet digjitale.

- Vazhdimin e bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtarë dhe shfrytëzimin e instrumenteve



të ndryshme për forcimin e kapaciteteve institucionale.

- Zhvillimin e regjistrimit të të dhënave të kontrolluesve dhe autoriteteve publike, si dhe krijimin e Regjistrimit Kombëtar të kërkesave dhe përgjigjeve të autoriteteve publike.

Miratuar në datën 2.3.2017

KRYETARI
Ilir Meta

UDHËZIM

Nr. 134, datë 10.3.2017

PËR PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË MASAVE SHITESË TË SIGURISË DHE LLOJIN E MASAVE QË DUHET TË MARRIN SUBJEKTET NË VARËSI TË AKTIVITETIT APO VLERËSIMIT TË RREZIKUT, SI DHE PROCEDURAT E NJOFTIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, pikës 2, të nenit 8 dhe pikës 2, të nenit 10, të ligjit 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”,

UDHËZOJ:

1. Subjektet publike/private, të cilat në varësi të aktivitetit që kryejnë dhe vlerësimit të riskut nga Policia e Shtetit, që detyrohen të marrin masa shtesë sigurie dhe niveli/lloji i tyre klasifikohen si më poshtë:

1.1 Subjektet e tregtimit me shumicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj, me fushëpamje brenda dhe në perimetrin e jashtëm të objektit.

b) Instalojnë sistem me kamera për leximin automatik të targave të automjeteve në hyrje/dalje të objektit dhe që ruajnë të dhënat deri në dy muaj.

c) Kontraktojnë Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike për ruajtjen e objektit.

d) Të hartojë skemën e ruajtjes dhe sigurimit të objektit e cila miratohet nga shefi i Komisarariatit të Policisë në territorin ku është objekti.

1.2 Subjektet që tregtojnë me pakicë karburante, gaz të lëngshëm, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj, me fushëpamje në perimetrin e objektit.

b) Instalojnë sistem me kamera për leximin automatik të targave të automjeteve në hyrje/dalje të objektit dhe që ruajnë të dhënat deri në dy muaj.

c) Të hartojë skemën e ruajtjes dhe sigurimit të objektit e cila miratohet nga shefi i Komisarariatit të Policisë në territorin ku është objekti.

Subjektet që ushtrojnë aktivitetet nga ora 23:00 deri 06:00, përveç masave të mësipërme, marrin dhe këtë masë shtesë:

d) Instalojnë bankomatë për shitjen me pakicë të karburantit, duke shmangur përdorimin në *cash* të lekut.

1.3 Subjektet që ruajnë dhe magazinojnë lëndë të rrezikshme (radioaktive, shpërthyes, helmuese dhe djegëse), lëndë plasëse dhe piroteknike, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj.

b) Instalojnë sistem me kamera për leximin automatik të targave të automjeteve në hyrje/dalje të objektit dhe që ruajnë të dhënat deri në dy muaj.

c) Kontraktojnë Shoqëri Private të Sigurisë Fizike.

d) Të hartojë skemën e ruajtjes dhe sigurimit të objektit e cila miratohet nga Shefi i Komisarariatit të Policisë në territorin ku është objekti.

1.4 Subjektet që merren me transportin e lëndëve të rrezikshme, (radioaktive, shpërthyes, helmuese dhe djegëse), plasëse dhe piroteknike, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj.

b) Instalojnë në automjetet që transportojnë këto lëndë sistem me GPS, që kontrollohet nga salla operative e vete subjektit ose subjekte të licencuara për monitorim dhe menaxhim në distancë të mjetit, në kohë reale me sistem satelitorë.

c) Zbatimi me përpikëri i rregullave të përcaktuara në VKM nr. 313, datë 15.4.2015, “Për përcaktimin e procedurave të dhënies së autorizimit për magazinimin, transferimin dhe asgjësimin e



lëndëve plasëse për përdorim civil dhe lëndëve piroteknike, fishekszjarrëve”.

d) Duhet të plotësojnë të gjitha detyrimet sipas ADR-së dhe marrëveshjes kuadër të Bashkimit Evropian.

1.5 Subjektet që ushtrojnë aktivitetin në transportin publik të udhëtarëve, studentëve, nxënësve të shkollave, marrin këto masa:

a) Instalojnë në automjetet që shërbejnë për transportin e udhëtarëve sistem me GPS, që kontrollohet nga salla operative e vete subjektit ose subjekte të licencuara për monitorim dhe menaxhim në distancë të mjetit në kohë reale me sistem satelitor.

b) Instalojnë në ambiente të brendshme sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server, deri në dy muaj, të cilat kontrollojnë gjithë bordin e mjetit të transportit.

1.6. Subjektet që disponojnë lokale nate, si disko, pub-e, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj, me fushë pamje në hyrje/dalje, ambientet e brendshme dhe në perimetër të objektit.

b) Instalojnë sistem me kamera për leximin automatik të targave të automjeteve në hyrje/dalje të parkimit të objektit dhe që ruajnë të dhënat deri në dy muaj.

c) Pajisin punonjësit me shërbim në hyrje të objektit me dedektor.

d) Të kontraktojë Shoqëri Private të Sigurisë Fizike, ku përveç punonjësve në hyrje duhet të ketë jo më pak se 1 punonjës sigurie për 40–50 persona.

e) Të hartojë skemën e ruajtjes dhe sigurimit të objektit, e cila miratohet nga shefi i Komisarariatit të Policisë në territorin ku është objekti.

1.7. Subjektet që disponojnë lojëra fati/kazino, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj, me fushë pamje në hyrje/dalje, ambientet e brendshme dhe në perimetër të objektit.

b) Instalojnë sistem me kamera për leximin automatik të targave të automjeteve në hyrje/dalje të parkimit të objektit dhe që ruajnë të dhënat deri në dy muaj.

c) Pajisin punonjësit me shërbim në hyrje të objektit me dedektor.

d) Pajisin punonjësit me shërbim në hyrje të objektit me lexues optik të kartave të identitetit.

e) Të kontraktojë Shoqëri Private të Sigurisë Fizike,

f) Të hartojë skemën e ruajtjes dhe sigurimit të objektit e cila miratohet nga shefi i Komisarariatit të Policisë në territorin ku është objekti.

1.8 Subjektet që ushtrojnë aktivitet nga ora 23:00 deri 06:00, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj, me fushë pamje në hyrje/daljet të objektit dhe ambientet e brendshme/jashtme.

1.9 Subjektet që administrojnë ujësjellësit, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj, me fushë pamje të hyrje/daljet të objektit dhe në ambientet e jashtme.

b) Kontraktojnë Shoqëri Private të Sigurisë Fizike.

c) Të hartojë skemën e ruajtjes dhe sigurimit të objektit, e cila miratohet nga shefi i Komisarariatit të Policisë në territorin ku është objekti.

1.10 Institucionet arsimore publike /private, të gjithë niveleve, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj, me fushë pamje në hyrje/daljet në objekt, në korridoret e brendshme dhe në perimetër të objektit.

1.11 Administratorët e stadioneve, pallateve të sportit, kinema, teatër, salla koncertesh, muze, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj, me fushë pamje në hyrje/daljet në objekt, në ambiente qëndrimi dhe në perimetër.

b) Kontraktojnë Shoqëri Private të Sigurisë Fizike.

c) Të hartojë skemën e ruajtjes dhe sigurimit të objektit e cila miratohet nga shefi i Komisarariatit të Policisë në territorin ku është objekti.



1.12 Administratorët e bankave të nivelit të dytë, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj, me fushë pamje në hyrje/daljet në objekt, në ambientet e brendshme dhe në vendin e operimit.

b) Pajisin punonjësit në hyrje të objektit me dedektor.

c) Kontraktojnë Shoqëri Private të Sigurisë Fizike.

d) Lidhin sinjalin me sallat e komandimit/drejti-mit të drejtorive/komisariateve të policisë.

e) Vendosin në hyrje të bankës sistem kafaze me hyrje të kontrolluar (dyer me hapje me kohë vonesë).

f) Të hartojë skemën e ruajtjes dhe sigurimit të objektit e cila miratohet nga shefi i Komisarariatit të Policisë në territorin ku është objekti.

1.13 Subjektet e këmbimit valutorë, dhe ato të tregtimit dhe përpunimit të metaleve të çmuara, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj, me fushë pamje në hyrje/dalje të objektit, në ambientet e brendshme dhe në vendin e operimit.

b) Vendosin xham antiplumb që ndanë pjesën ku qëndron punonjësi dhe vlerat monetare nga ambienti ku u shërbehet për klientët.

c) Kontraktojnë Shoqëri Private të Sigurisë Fizike, për shoqërim kur transportojnë vlera monetare mbi 1.000.000 lekë.

1.14 Subjektet që administrojnë hidrocentrale, termocentrale publik/privat, n/stacionet elektrike, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj, me fushë pamje në hyrje/dalje, ambientet e brendshme dhe në perimetër të objektit.

b) Kontraktojnë Shoqëri Private të Sigurisë Fizike.

c) Të hartojë skemën e ruajtjes dhe sigurimit të objektit, e cila miratohet nga shefi i Komisarariatit të Policisë në territorin ku është objekti.

1.15 Administratorët e terminaleve të trageteve, aeroporteve, autobusëve, taksive, trenave, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj me fushë pamje në hyrje/dalje, në ambientet e brendshme dhe në perimetër.

b) Instalojnë sistem me kamera për leximin automatik të targave të automjeteve në hyrje/dalje të objektit dhe që ruajnë të dhënat deri në dy muaj.

c) Kontraktojnë Shoqëri Private të Sigurisë Fizike.

d) Të hartojë skemën e ruajtjes dhe sigurimit të objektit, e cila miratohet nga shefi i Komisarariatit të Policisë në territorin ku është objekti.

1.16 Qendrat spitalore universitare dhe rajonale shëndetësore publike/private, marrin këto masa:

a) Të instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj me fushë pamje hyrje/daljet në objekt dhe ambientet e pritjes së pacientëve.

b) Të kontraktojnë Shoqëri Private të Sigurisë Fizike.

c) Të hartojë skemën e ruajtjes dhe sigurimit të objektit, e cila miratohet nga shefi i Komisarariatit të Policisë në territorin ku është objekti.

1.17 Subjektet që administrojnë kënde e lojërash publike/privat, të mbyllura, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj, me fushë pamje në hyrje/dalje dhe në ambientet e brendshme të objektit.

1.18 Subjektet që kanë në pronësi/administrim, qendra tregtare, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj dhe me fushë pamje në hyrje/dalje, ambientet e brendshme, në parkingje dhe perimetër të objektit.

b) Instalojnë sistem me kamera për leximin automatik të targave të automjeteve në hyrje/dalje të parkimit të objektit dhe që ruajnë të dhënat në NVR/server deri në dy muaj.

c) Kontraktojnë Shoqëri Private të Sigurisë Fizike.



d) Të kenë Qendër Kontrolli (sallë operative) në funksion 24h/24h.

e) Të caktojnë një person përgjegjës për sigurinë, i cili mban kontakte me strukturat e Policisë së Shtetit.

f) Të hartojë skemën e ruajtjes dhe sigurimit të objektit, e cila miratohet nga shefi i Komisarariatit të Policisë në territorin ku është objekti.

Në rast se brenda ambienteve të qendrës tregtare ushtrohen aktivitete të tjera, si disko/kazino, përveç masave të mësipërme, detyrohen ta marrin masa shtesë sipas pikës 1.7 të këtij udhëzimi.

1.19 Administratorët e tregjeve publike/private, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj, me fushë pamje në hyrje/dalje, në ambientet e brendshme dhe në perimetrin e jashtëm të objektit.

1.20 Të gjitha subjektet, të cilat gjatë realizimit të veprimtarisë së tyre ekonomike, në ambiente të hapura/mbyllura, kanë mbi 50 punonjës, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj, me fushë pamje në hyrje/dalje, ambientet e brendshme dhe në perimetrin e jashtëm të objektit.

b) Kontraktojë Shoqëri Private të Sigurisë Fizike.

c) Të hartojë skemën e ruajtjes dhe sigurimit të objektit, e cila miratohet nga shefi i Komisarariatit të Policisë në territorin ku është objekti.

1.21 Të gjitha subjektet të cilat gjatë realizimit të veprimtarisë së tyre ekonomike, realizojnë një xhiro vjetore prej 10 milionë lekë, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj, fushë pamje në hyrje/daljet, ambientet e brendshme/jashtme të objektit.

1.22 Administratorët e parkingjeve publike/private të hapura/mbyllura, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në

dy muaj, me fushë pamje në hyrje/dalje, ambientet e brendshme dhe në perimetrin jashtë objektit.

b) Instalojnë sistem me kamera për leximin automatik të targave të automjeteve në hyrje/dalje të objektit dhe që ruajnë të dhënat deri në dy muaj.

c) Kontraktojë Shoqëri Private të Sigurisë Fizike.

1.23 Institucionet qendrore shtetërore, përjashtuar ato që ruajtja dhe sigurimi i tyre bëhet nga Garda Republikës, Policia e Shtetit, Policia e Burgjeve dhe ajo bashkiake, marrin këto masa:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/server deri në dy muaj, me fushë pamje në hyrje/dalje, ambientet e brendshme dhe në perimetrin e jashtëm objektit.

b) Kontraktojë Shoqëri Private të Sigurisë Fizike.

c) Instalojnë në hyrje të objektit lexues karte identiteti.

1.24 Pas dakordësimit me banorët e pallatit, administratorët e pallateve në bashkëpunim edhe me banorët marrin këto masa shtesë sigurie:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/Server deri në dy muaj me fushë pamje në hyrje/dalje të pallatit.

2. Procedurat e identifikimit dhe njoftimit të subjekteve për vlerësimin dhe gjendjen e rrezikut dhe nivelin e masave shtesë të sigurisë që duhet të marrë, janë:

2.1 Identifikimi i subjekteve, të cilat duhet të marrin masa shtesë sigurie, bëhet nga strukturat vendore të policisë, nëpërmjet shërbimit të specialistit për krimet në bashkëpunim me ndihmëspecialistin e policimit në komunitet.

2.2 Vlerësimi i subjekteve, të cilat detyrohen të marrin masa shtesë sigurie dhe nivelin e tyre, bëhet nga komisioni i vlerësimit të masave të sigurisë, pranë drejtorisë vendore të policisë, i cili ngrihet me urdhër të drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë (DVP) me këtë përbërje:

- | | |
|---|---------|
| a) Zv.drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë | Kryetar |
| b) Shefi i Komisarariatit në juridiksion të të cilit ushtron aktivitetin subjekti | Anëtar |
| c) Shefi i Sektorit për krimet në DVP | “ |
| d) Specialisti i TI në DVP | “ |
| e) Juristi i Drejtorisë Vendore të Policisë | “ |



2.3 Komisioni bën analizën e vlerësimit të rrezikut për çdo objekt/subjekt, duke u bazuar në këto faktorë:

a) Nëse objekti/subjekti, ka qenë objekt i sulmeve të përsëritura kriminale në 5 vitet e fundit.

b) Nivelin e ekspozimit të mjediseve të aktivitetit ndaj elementëve kriminalë.

c) Distancën e objektit nga njësia policore apo qendrat e banuara.

d) Llojin e veprimtarisë që kryen subjekti, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 të këtij udhëzimi.

e) Shkalla e mbulimit me shërbime policore (llojin e shërbimit, numrin e punonjësve të policisë) të territorit ku ushtron veprimtarinë subjekti.

2.4 Shefi i Komisarariatit në territorin e të cilit ushtrojnë aktivitetin subjektet e identifikuar për marrjen e masave shtesë të sigurisë, përgatit listën e subjekteve me relacion sqarues për secilin subjekt dhe me shkresë përcjellëse ia dërgon komisionit përkatës në DVP.

2.5 Komisioni i vlerësimit të masave shtesë të sigurisë pranë DVP mblidhet me kërkesë të kryetarit të komisionit, sa herë ka kërkesa nga komisarariatet e policisë për vlerësim, por jo më pak se një herë në muaj.

2.6 Komisioni i vlerësimit të masave shtesë të sigurisë, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur, bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi merr vendim nominalisht për çdo subjekt me shumicë votash, për masat nivelin dhe llojin e masës së sigurisë.

2.7 Vendimet e komisionit i dërgohen komisarariatit përkatës, i cili me shkresë zyrtare, brenda 5 ditëve, njofton subjektet për marrjen e masave shtesë dhe llojin e tyre.

2.8 Të gjitha subjektet e përcaktuara nga Komisioni i Vlerësimit për masat shtesë të sigurisë, detyrohen që, brenda 60 ditëve nga marrja e njoftimit, të vendosin masa shtesë sigurie, sipas përcaktimeve të bëra nga komisioni, si dhe njofton komisarariatit e policisë për vendosjen e tyre.

2.9 Kontrolli i marrjes së masave shtesë të sigurisë bëhet nga Komisioni i Verifikimit, i ngritur pranë çdo komisaritati me këtë përbërje:

a) Shefi/specialist i Seksionit për Krimet Kryetar

b) Shefi/specialist i Rendit/Policimit në komunitet Anëtar

c) Specialisti për krimet i zonës përkatëse. “

d) Ndihmëspecialisti i policimit në komunitet i zonës përkatëse “

e) Specialisti i TI-së Anëtar

2.10 Komisioni i Verifikimit, pasi kontrollon masat shtesë të marra nga subjekti dhe rezulton se ato janë sipas përcaktimeve të Komisionit të Vlerësimit, informon me shkrim shefin e Komisarariatit Policisë, i cili i propozon drejtorit vendor të policisë lëshimin e “Vërtetimit të sigurisë”.

2.11 Drejtori vendor i policisë, brenda 15 ditëve nga vendosja e masave të sigurisë, pajisë subjektin me “Vërtetim Sigurie”.

2.12 Për subjektet ekzistuese, të përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi, njoftimi për marrjen e masave shtesë të sigurisë do fillojë menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, ndërsa për subjektet e tjera që fillojnë aktivitetin pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, njoftimi bëhet pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), jo më vonë se 5 ditë.

3. Vendosja dhe mirëmbajtja e sistemit të kamerave dhe të pajisjeve të teknologjisë në të gjithë objektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij udhëzimi, bëhen nga subjekte të regjistruara në Regjistrin Kombëtar Tregtar dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

4. Subjektet janë të detyruara që në rast defekti i sistemit të sigurisë të njoftojnë komisarariatit e policisë brenda 24 orëve dhe të marrin masa për riparimin e defekteve menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë, duke njoftuar komisarariatit e policisë.

5. Në komisarariatet e policisë, seksionet e policimit në komunitet/rendit publik të ruajnë dhe administrojnë në një dosje të veçantë, kopje të skemave të ruajtjes dhe sigurimit të objekteve dhe vërtetimin e sigurisë për secilin subjekt, që ka marrë masa shtesë sigurie në territorin në juridiksion të komisarariatit të policisë.

6. Me këtë udhëzim të njihen të gjithë subjektet publike dhe private, subjekt i këtij ligji dhe punonjësit e Policisë së Shtetit.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Policisë së Shtetit, drejtoritë vendore të policisë dhe komisarariatet e policisë në varësi të tyre, si dhe të gjitha subjektet publike apo private që marrin detyrime në bazë të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.



8. Me kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

KËRKESË

Shtetasi Petrit Arixhiu lindur dhe banues në Tiranë, kërkon shpalljen të zhdukur që nga viti 2000 të babait të tij Hekuran Abdyl Arixhiu dhe caktimin si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij shtetasen Lindita Arixhiu.

KËRKUES
Petrit Arixhiu

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 042427006

Çmimi 84 lekë